



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 prill 2015  
Nr. ref.: AGJ 788/15

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin nr. KO26/15**

**Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të  
propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars  
2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
me Shkresën nr. 05-433/DO-318**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një amendament (Amendamenti nr. 24) të Kushtetutës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).

## Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata nëse amendamenti i propozuar i Kushtetutës “[...] *zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës*”, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.
- Amendamenti i propozuar konsiston në shtimin e një neni të ri, nenit 162, pas nenit 161 [Transicioni i Institucioneve] të Kushtetutës.

## Baza juridike

- Kërkesa është e bazuar në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës dhe në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## Procedura në Gjykatë

- Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës e referoi amendamentin në Gjykatë.
- Më 10 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO26/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO26/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
- Më 11 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit, deputetëve të Kuvendit dhe Avokatit të Popullit.
- Më 18 mars 2015, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes dorëzoi komentet lidhur me Rastin KO26/15.
- Më 14 prill 2015, Gjyqtari raportues i paraqiti raportin Kolegjit shqyrtues. Kolegji shqyrtues e miratoi atë dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që kërkesa të deklarohej e pranueshme për shqyrtim dhe të konfirmohej se amendamenti i propozuar nuk pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me frymën e me shkronjën e saj, siç është përcaktuar me praktikën gjyqësore të Gjykatës.
- Në të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.
- Gjyqtari Kadri Kryeziu nuk mori pjesë në procedurat dhe në vendimin e Gjykatës përkitazi me rastin e tanishëm KO26/15, në bazë të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, KK124/14, të 19 gushtit 2014.

## Përmbledhja e fakteve

- Më 7 mars 2015, Qeveria vendosi t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës një amendament të Kushtetutës.

13. Të njëjtën ditë, Qeveria, në bazë të nenit 144 [Amendamenti], paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozoi Kryetarit të Kuvendit amendamentimin e Kushtetutës.
14. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit i referoi Gjykatës amendamentin e Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata që ajo të bëjë vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj.
16. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar dhe, së dyti, duhet të përcaktojë nëse ka juridiksion për të vlerësuar amendamentin e Kushtetutës të propozuar nga Qeveria, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.
17. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, "*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara [...]*".
18. Gjykata vëren se kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, e referoi amendamentin e propozuar. Kësisoj, Gjykata konkludon se kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës.
19. Prandaj, në bazë të të njëjtit nen, 113.9, Gjykata duhet "*[...] të konstatojë nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës*".
20. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion të vlerësojë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ose jo të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
21. Meqë është dorëzuar nga pala e autorizuar dhe meqë Gjykata ka juridiksion të gjykojë lidhur me rastin, kërkesa është e pranueshme.

### **Fushëveprimi i vlerësimit**

22. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e frymën e Kushtetutës (Shih rastet KO29/12 dhe KO48/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012; dhe shih, gjithashtu, Rastin nr. KO61/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 tetorit 2012).

## **Amendamenti i propozuar nr. 24: Neni i ri 162 i Kushtetutës që do të shtohet pas nenit 161 të Kushtetutës**

23. Amendamenti i propozuar konsiston në shtimin e një neni të ri, të nenit 162, në Kushtetutë, ku thuhet si vijon:

“ ...

*Neni 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar]*

*Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:*

- 1. Për t'i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të specializuara [N. B.: fjala “specialist” në tekstin anglisht thuhet “e specializuar” në tekstin në shqip, ndërsa “specijalne” në tekstin serbisht] dhe një Zyrë të Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.*
- 2. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55.*
- 3. Një Dhomë e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë të emëruar shtesë krahas gjyqtarëve të referuar sipas Nenit 114 (I), do të vendosë ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese sipas Nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me Dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me ligjin e veçantë.*
- 4. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të kenë zotësi të plotë ligjore dhe juridike dhe do të kenë të gjitha kompetencat e nevojshme dhe mandatin për veprim bashkëpunim juridik, asistencë, mbrojtje të dëshmitarëve, siguri, paraburgim dhe vuajtje të dënimit jashtë territorit të Kosovës për këdo që dënohet, si dhe në lidhje me menaxhimin e ndonjë çështjeje të mbetur pas përfundimit të mandatit. Aranzhimet që dalin nga ushtrimi i këtyre kompetencave nuk i nënshtrohen Nenit 18.*
- 5. Para hyrjes në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare me një shtet të tretë në lidhje me bashkëpunimin juridik, që përndryshe do të kërkonte ratifikim sipas Nenit 18, Dhomat e specializuara do të kërkojnë pajtimin paraprak të Qeverisë.*
- 6. Dhomat e specializuara mund t'i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare*

për të drejtat e njeriut të përfshira në Nenin 22 dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të rishikojë këto Rregulla për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

7. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të kenë seli në Kosovë dhe seli jashtë Kosovës. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të ushtrojnë funksionet e tyre në të dyja selitë apo diku tjetër, sipas nevojës.
8. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, çdo person i akuzuar për krime nga Dhomat e specializuara mund të paraburgoset dhe të transferohet në Dhomat e Specializuara që ndodhen jashtë territorit të Kosovës. Nëse shpallen fajtorë dhe dënohen me burgim, këta persona mund të transferohen për ta vuajné dënimin e tyre në një shtet të tretë, jashtë territorit të Kosovës, në pajtim me marrëveshjet arritura sipas paragrafit 4.
9. Gjuhët zyrtare të Dhomave të specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar do të jenë gjuha shqipe, serbe dhe ajo angleze. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të vendosin mbi përdorimin zyrtar të gjuhës apo gjuhëve për ta ushtruar mandatin e tyre.
10. Emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe prokuroreve, si dhe mbikëqyrja dhe administrimi i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar bëhet në pajtim me ligjin e veçantë.
11. Do të emërohet një Ombudsperson i veçantë i Dhomave të specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të specializuar. Funksioni dhe obligimet e tij/saj për raportim do të përcaktohen me [ligjin e veçantë]. Nenet 133 (2), 134, 135 (1) dhe (2) nuk do të aplikohen ndaj Ombudspersonit të Dhomave të specializuara. Ombudspersoni i Kosovës gjithashtu mund të referojë çështje në përputhje me Nenin 135 (4).
12. Procedurat e veçanta administrative, modalitetet, organizimi dhe funksionimi i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorisë së specializuar, mbikëqyrja, buxheti, auditimi dhe funksionet tjera, do të rregullohen me marrëveshje ndërkombëtare, me ligjin e veçantë dhe përmes aranzhimeve të bëra sipas paragrafit 4.
13. Mandati i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të specializuar do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin No. 04/L. 274 bëhet me herët.
14. Në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit

të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.

## II.

*Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.*

...”.

### **Komentet e Grupit parlamentar të Vetëvendosjes**

24. Më 18 mars 2015, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes i dorëzoi Gjykatës komentet përkitazi me amendamentin e Kushtetutës. Në komente thuhet se amendamenti është në kundërshtim me karakterin dhe me subjektivitetin e Republikës së Kosovës dhe nuk është në përputhje me nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit], paragrafët 1 dhe 2; me nenin 3 [Barazia para Ligjit]; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut; me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; me nenin 35 [Liria e Lëvizjes]; me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], pika 4, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]; me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; me nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]; me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]; me nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]; me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; me nenin 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] dhe me nenin 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.
25. Ata pretendojnë se projektamendamenti ka për qëllim të krijojë organe paralele gjyqësore, ndërsa askund në projektamendament nuk specifikohen “*[...] elemente të varësisë së këtyre organeve paralele gjyqësore [...]*” në raport me organet kushtetuese. Pra, emërimi, përzgjedhja dhe përgjegjësia nuk janë sanksionuar në projektamendament.
26. Sipas Grupit parlamentar të Vetëvendosjes, projektamendamenti është duke krijuar “*[...] bazën kushtetuese që në sistemin juridik të gjyqësisë së Republikës së Kosovës të krijohen normat ligjore të natyrës sui generis të cilat do ta njohin të drejtën e një organizimi tërësisht të veçantë i cili nuk do t'i nënshtrohet rregullimit generalis të Kosovës*”.
27. Ata konsiderojnë se “*Dhoma e specializuar siç është quajtur nga sponzorizuesi është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 114 të Kushtetutës për sa i përket përbërjes së saj. Elementi tjetër sa i përket kolizionit që janë duke krijuar këto norma në këtë draft-amendament është edhe kompetenca lëndore e kësaj dhome të ‘specializuar’ në raport me Nenin 112 dhe 113 të Kushtetutës*”.
28. Për më tepër, sipas Grupit parlamentar të Vetëvendosjes, “*sipas paragrafit 4, Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të kenë aftësi*

të plotë juridike që në kuptimin e përgjithshëm të hynë në marrëdhënie ndërkombëtare dhe kështu [...] Kuvendi i Kosovës është përjashtuar nga ratifikimi, apo dhënia e instrumentit të brendshëm (pëlqimit) për lidhjen e këtyre marrëveshjeve me karakter ndërkombëtar”.

29. Grupi parlamentar i Vetëvendosjes, sa i përket amendamentit të propozuar, nenit 162, paragrafi 5, të Kushtetutës, konsideron se “[...] me këtë draft-amendament, dispozitat e paragrafit 5 i cenon kompetencat e Kuvendit të Kosovës siç janë paraparë me Nenin 65, pikës 4 të Kushtetutës përkitazi me kompetencën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra pëlqimi për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare që do t'i lidhin dhomat e specializuara dhe zyra e prokurorit të specializuar do të merret vetëm nga Qeveria dhe jo nga Kuvendi i Kosovës siç, është paraparë me Nenin 18 të Kushtetutës”.
30. Ata pretendojnë se “sipas paragrafit 6 të draft-amendamentit [...] Me dhënien e autorizimit kushtetues që këto dhoma dhe zyra e Prokurorit të kenë të drejtën që të nxjerrin rregulla të reja procedurale, të akuzuarit në procedurat e zhvilluara pranë tyre i bën të diskriminuar në kuptimin e mbrojtjes së tyre nga ligji dhe shfrytëzimit të mjeteve juridike përmes rregullave që janë të parapara me ligjet në fuqi të shtetit, shtetas të të cilit janë”.
31. Përkitazi me amendamentin e propozuar, nenin 162, paragrafët 7 dhe 8, të Kushtetutës, ai “[...] ndërlidhet me ekstradimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës e që sipas Nenit 35, paragrafit 4, ekstradimi i qytetarëve të Kosovës në kuadër të së drejtës themelore të njeriut përkitazi me lirinë e lëvizjes, ndalohet ekstradimi i tij, përjashtimisht kur kjo është e rregulluar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare”.
32. Grupi parlamentar i Vetëvendosjes konsideron se “paragrafi 10 i draft-amendamentit përjashton në tërësi aplikimin e dispozitave të Nenit 104 të Kushtetutës së Kosovës. Vënia në dispozicion që çështja e emërimit të gjyqtarëve t'i lihet në dispozicion rregullimit ligjor i cili prapë nën klauzolën përjashtuese të rregullojë emërimin e gjyqtarëve jashtë standardit të përcaktuar me Nenin 104 të Kushtetutës dhe dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës [...]”.
33. Ata më tej pretendojnë se “sipas paragrafit 11 të draft-amendamentit është paraparë themelimi i një Ombudspersoni të veçantë i Dhomave të Specializuara, i cili nuk do të zgjidhet dhe as nuk do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës sipas dispozitave të Neneve 132, par. 2 dhe Neneve 134 dhe 135 par. 1 dhe 2 të Kushtetutës së Kosovës”.
34. Si përfundim, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes konsideron se “nuk është e paraparë as në teorinë e as në praktikën e hartimit të normimit kushtetues që dispozita kushtetuese t'i referohet një akti ligjor i cili i subordinohet aktit kushtetues. Kjo krijon pasiguri juridike dhe kushtetuese dhe një normim i tillë e cenon rendin juridik në përgjithësi sepse përderisa dispozitat kushtetuese kalojnë nëpër një procedurë të veçantë kushtetuese dhe miratimin sipas shumicës së dyfishtë të kualifikuar në pajtim me Nenin 144, par. 2 të Kushtetutës, [...]”.

## Vlerësimi i amendamentit të propozuar

35. Amendamenti i propozuar do të vlerësohet nga Gjykata në pajtim me fushëveprimin e vlerësimit të përkufizuar më lart. Fillimisht, Gjykata do të ekzaminojë elementet strukturore të krijuara me këtë amendament, përkitazi me marrëdhënien e tyre me strukturat ekzistuese të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës.
36. Gjykata vëren se amendamenti i propozuar i Kushtetutës përmban katër elemente strukturore që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës.
  - a. Elementi i parë është themelimi i dhomave të specializuara në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës;
  - b. Elementi i dytë është krijimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës;
  - c. Elementi i tretë është themelimi i një dhome të specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, të përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë, të cilët vendosin ekskluzivisht për kërkesat kushtetuese sipas nenit 113 të Kushtetutës, në lidhje me dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;
  - ç. Elementi i katërt është emërimi i Ombudspersonit të veçantë të dhomave të specializuara me përgjegjësi ekskluzive për dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
37. Gjykata rikujton se propozimi i amendamenteve të lartpërmendura kushtetuese buron nga Marrëveshja Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e 14 prillit 2014.
38. Më 23 prill 2014, Kuvendi, me shumicën e dy të tretave, miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, nr. 04/L-274 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 04/L-274). Ky ligj hyri në fuqi më 30 maj 2014.
39. Gjykata vëren se amendamenti thekson që themelimi i dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës është kërkesë për Republikën e Kosovës që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Dokumenti 12467), të 7 janarit 2011.
40. Për të ekzaminuar marrëdhënien ndërmjet elementeve strukturore të amendamentit dhe të sistemit të drejtësisë, Gjykata i referohet nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafi 5, të Kushtetutës, që përcakton se *“pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat”*.



41. Natyra e ushtrimit të pushtetit gjyqësor elaborohet më tej në Kapitullin VII të Kushtetutës, që përcakton strukturën e sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës thuhet si në vijim:
- “1. *Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
  2. *Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
  3. *Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
  4. *Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
  5. *Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese”.*
42. Gjithashtu, neni 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], paragrafi 7, i Kushtetutës, parasheh të drejtën kushtetuese të Republikës së Kosovës për të themeluar gjykata të specializuara. Aty thuhet: *“Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme”.*
43. Gjykata konsideron se gjykata e specializuar, siç është paraparë me këtë dispozitë, do të thotë gjykatë me fushëveprim të specifikuar të juridiksionit që mbetet brenda kornizës ekzistuese të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe që vepron në përputhje me parimet e atij sistemi. Për dallim nga gjykata e specializuar, një “gjykatë e jashtëzakonshme” do të vendosej jashtë strukturës së sistemit ekzistues gjyqësor dhe do të vepronte pa iu referuar sistemeve ekzistuese.
44. Si e tillë, Gjykata gjen se, në mënyrë që një gjykatë e specializuar të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese që autorizojnë themelimin e gjykatave të tilla, struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe metoda e funksionimit të një gjykate të tillë, duhet të jenë në pajtueshmëri me të drejtat e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me kornizën e përgjithshme të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.
45. Po ashtu, Gjykata vëren se janë dy kërkesa formale të parapara me nenin 103, paragrafi 7, të Kushtetutës, për krijimin e një gjykate të specializuar. E para, ajo duhet të jetë e bazuar në ligj dhe, e dyta, duhet të ekzistojë nevoja për themelimin e saj.
46. Sa i përket kërkesës së parë, Gjykata vëren se amendamenti i propozuar parasheh në nenin 162, paragrafi 1, që

- a. Dhomat e specializuara do të themelohen në kuadër të gjykatave tashmë të themeluara brenda sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës, ngjashëm me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kjo dhomë e posaçme u themelua me Ligjin për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 04/L-033, të 31 gushtit 2011, e cila në bazë të nenit 21.2 të Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199, është pjesë e Gjykatës Supreme.
  - b. Themelimi i dhomave të specializuara do të bëhet nëpërmjet miratimit të një ligji të veçantë nga Kuvendi, i cili do të rregullojë “[...] organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e tyre [...]”.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) në rastin *Fruni kundër Sllovakisë* (Shih Rastin *Fruni kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 8014/07, Aktgjykim i 21 qershorit 2011).
  48. Në këtë rast, GJEDNJ-ja konstatoi që “[...] Neni 6 § 1 nuk mund të lexohet ashtu që ndalon themelimin e gjykatave speciale penale nëse ato kanë bazën në ligj (Shih *Erdem kundër Gjermanisë* (dec.), nr. 38321/97, 9 dhjetor 1999). GJEDNJ-ja ritheksoi se “[...] objekti i termit ‘e themeluar me ligj’ në nenin 6 të Konventës është të sigurojë ‘që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet nga diskrecioni i ekzekutivit, por që të rregullohet me ligj që buron nga Parlamenti’”.
  49. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh që amendamenti i propozuar ka për qëllim të themelojë me ligj dhomat e specializuara, ai është në përputhje me atë kërkesë të nenit 103, paragrafi 7, të Kushtetutës.
  50. Sa i përket kërkesës së dytë në nenin 103, paragrafi 7, konkretisht që Gjykata e Specializuar duhet të jetë “e nevojshme”, Gjykata vëren se në amendamentin e propozuar thuhet se themelimi i dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës është kërkesë për Republikën e Kosovës që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare.
  51. Këto obligime ndërkombëtare burojnë nga Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Dokument i 12462), i 7 janarit 2011, që përmbledh një numër të pretendimeve penale shumë specifike dhe që rekomandon që ato të hetohen dhe të ndiqen penalisht. Këto obligime u inkorporuan në kornizën juridike të Republikës së Kosovës nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 04/L-274 nga shumica e dy të tretave të Kuvendit.
  52. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të lartpërmendur të GJEDNJ-së, *Fruni kundër Sllovakisë*, ku GJEDNJ-ja pranoi se “[...] luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar mund të kërkojë masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar”.

53. Prandaj, Gjykata gjen se fushëveprimi i juridiksionit të dhomave të specializuara, siç parashihet me amendament, është gjithashtu në pajtueshmëri me kërkesën e “nevojës” që e përmban neni 103, paragrafi 7, i Kushtetutës.
54. Përveç kësaj, në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, të cituar më lart, dhomat e specializuara gjyqësore që do të themelohen me amendamentin, janë po ashtu në pajtueshmëri me kërkesën për të qenë të bazuara në ligj dhe për të qenë brenda fushëveprimit të specializuar të juridiksionit. Prandaj, amendamenti përmbush kërkesat për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, siç përcaktohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.
55. Gjithashtu, amendamenti përcakton që procedurat e veçanta administrative, modalitetet, organizimi dhe funksionimi i dhomave të specializuara, mbikëqyrja, buxheti, auditimi dhe funksionet e tjera, do të rregullohen, *inter alia*, me ligj të veçantë. Dhomat e specializuara mund t'i përcaktojnë rregullat e veta të procedurës dhe të provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës, të cilat do të vlerësohen nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës. Këto rregulla do të udhëhiqen nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
56. Gjykata po ashtu vëren se në paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit nr. 24 është paraparë që mandati i dhomave të specializuara të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç nëse bëhet njoftimi për përfundimin e mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.
57. Për me tepër, Gjykata vëren se, në bazë të amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 2, Kushtetuta do të respektohet nga dhomat e specializuara të themeluara, posaçërisht do të respektohen mbrojtjet e sanksionuara në Kapitullin II, dhe ato do të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenin 22 dhe në varshmëri të nenit 55. Këto janë garanci procedurale për ata që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara.
58. Prandaj, Gjykata gjen se metodat e funksionimit të dhomave të specializuara janë brenda kornizës së sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës.
59. Gjykata konkludon se dhomat e specializuara do të themelohen në kuadër të *pushtetit gjyqësor unik dhe të pavarur që ushtrohet nga gjykatat* në bazë të Kushtetutës. Struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i dhomave të specializuara do të rregullohen me ligje të tjera, në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, dhomat e specializuara nuk pakësojnë të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
60. Sa i përket propozimit për themelimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Gjykata vëren se themelimi i saj ndjek të njëjtin parim sikurse dhomat e specializuara. Fushëveprimi i juridiksionit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të jetë për të njëjtat krime specifike sikurse për dhomat e specializuara. Për më tepër, ashtu sikurse dhomat e specializuara, sipas paragrafit 2 të

amendamentit, edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të zbatohet dhe të respektojë standardet dhe parimet e sanksionuara në Kapitullin II dhe të veprojë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenin 22 dhe me nenin 55 të Kushtetutës.

61. Gjykata gjithashtu vëren se në paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit nr. 24 është paraparë që mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç nëse bëhet njoftimi për përfundimin e mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.
62. Si e tillë, Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohet në kuadër të sistemit ekzistues prokurorial të Republikës së Kosovës. Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohet me ligj, i cili do të rregullojë “[...] organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e saj [...].”
63. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se amendamenti i propozuar është në pajtim me garancitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe se ligje e rregullore të tjera do të hartohen brenda kornizës së sistemit të drejtësisë për të mbrojtur më tej të drejtat themelore të personave që hyjnë në juridiksionin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
64. Gjykata konkludon se amendamenti për themelimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
65. Sa i përket amendamentit të propozuar për themelimin e një dhome të specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata rithekson të gjeturat e saj të mësipërme dhe vëren se Dhoma e Specializuar do të themelohet në kuadër të Gjykatës Kushtetuese ekzistuese. Kjo dhomë e specializuar, nëpërmjet vlerësimit të saj kushtetues të rregullave të procedurës dhe të provave, dhe nëpërmjet mekanizimit të ankesave individuale kushtetuese, do të ushtrojë juridiksion mbikëqyrës mbi dhomat e specializuara në kuadër të gjykatave të rregullta dhe mbi Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
66. Prandaj, Gjykata konkludon se amendamenti i propozuar për themelimin e Dhomës së Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
67. Sa i përket amendamentit të propozuar për themelimin e një ombudspersoni të veçantë të dhomave të specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të specializuar, Gjykata rithekson të gjeturat e saj të mësipërme dhe konkludon se amendamenti i propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
68. Si përfundim, Gjykata gjen se katër elementet e reja strukturore të futura në Kushtetutë me amendament: (a) do të themelohen me ligj, (b) do të jenë në

pajtim me strukturën ekzistuese të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës, (c) do të kenë fushëveprim specifik të juridiksionit, (ç) do të funksionojnë në kuadër të kornizës juridike të drejtësisë penale, dhe (d) janë të nevojshme për Republikën e Kosovës ashtu që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se themelimi i katër elementeve strukturore në sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës hyn në kuadër të sistemit ekzistues të drejtësisë të Kosovës dhe i përgjigjet karakteristikave të sistemit kushtetues të pushtetit të pavarur gjyqësor.

69. Sa i përket komenteve të dorëzuara nga Grupi parlamentar i Vetëvendosjes, Gjykata vëren se këto komente janë ekskluzivisht të drejtuara në faktin se amendamenti themelon elemente të reja strukturore që nuk janë paraparë më herët me Kushtetutë. Megjithatë, Gjykata ka gjetur se themelimi i këtyre elementeve të reja strukturore, në vetvete, nuk krijon ndonjë kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, sepse struktura, fushëveprimi dhe funksionimi i tyre janë në pajtueshmëri me Kapitullin II si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën dhe frymën e Kushtetutës, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
70. Gjykata do të vlerësojë amendamentin e nenit të propozuar 162, paragraf për paragraf.

#### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 1***

71. Sa i përket amendamentit të nenit 162, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata vëren se krijimi i katër elementeve strukturore në kuadër të sistemit të drejtësisë buron nga sovraniteti i Republikës së Kosovës, ku Kuvendi, me shumicën e dy të tretave, miratoi Ligjin nr. 04/L-274. Kjo është në pajtueshmëri me nenin 103, paragrafi 7, dhe me nenin 31 të Kushtetutës, sepse këto elemente të reja strukturore në sistemin e drejtësisë të Kosovës bëhen me ligj dhe me qëllim të luftimit të krimeve specifike, të cilat në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së kërkojnë masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar.
72. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 1 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

#### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 2***

73. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 2, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai përfshin garancitë procedurale për personat që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
74. Paragrafi 2 obligon dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar që të respektojnë mbrojtjet e sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Lidhur me këtë, vërehet se, nëpërmjet nenit 53 të Kushtetutës, duhet të zbatohet edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së.

75. Përveç këtyre garancive procedurale, të sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës, vërehet se dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës, që do të thotë se çdo kufizim i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore duhet të bëhet në pajtim me nenin 55. Sidoqoftë, siç parashihet me nenin 56 të Kushtetutës, shmangia nga disa të drejta të njeriut dhe liri themelore të sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës nuk lejohet në asnjë rrethanë.
76. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 2 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 3***

77. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 3, të Kushtetutës, Gjykata vëren se krijimi i Dhomës së Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese është një garantues shtesë i Kushtetutës. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të jenë nën juridiksionin e saj mbikëqyrës nëpërmjet ankesave të mundshme kushtetuese në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës.
78. Dhoma e Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese do të respektojë të njëjtat standarde dhe parime të sanksionuara në Kushtetutë, sikurse Gjykata Kushtetuese ekzistuese. Megjithatë, fushëveprimi i kërkesave që mund të paraqiten pranë kësaj dhome do të jetë ekskluzivisht në lidhje me dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
79. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 3 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 4***

80. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 4, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai siguron që dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të përkujdesen plotësisht për të gjitha elementet e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për garancitë e tjera procedurale ndaj personave që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Kjo do të bëhet nëpërmjet kompetencave të nevojshme dhe mandatit për veprim, për bashkëpunim juridik, për asistencë, për mbrojtje të dëshmitarëve, për siguri, për paraburgim dhe për vuajtje të dënimit jashtë territorit të Republikës së Kosovës për këdo që dënohet, si dhe për menaxhimin e ndonjë çështjeje të mbetur pas përfundimit të mandatit.
81. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 4 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 5***

82. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 5, të Kushtetutës, Gjykata vëren se, edhe pse aranzhimet që dalin nga ushtrimi i kompetencave të përmendura në paragrafin 4 nuk i nënshtrohen nenit 18, megjithatë, për këto aranzhime, do të kërkohet pajtimi i Qeverisë. Prandaj, para lidhjes së ndonjë traktati ndërkombëtar për bashkëpunimin gjyqësor, procedura për kërkimin e pajtimit të Qeverisë do të jetë në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.
83. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 5 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 6***

84. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 6, të Kushtetutës, Gjykata vëren se këto janë garanci shtesë që do të përfshihen në rregullat e procedurës dhe të provave të dhomave të specializuara. Rregullat e procedurës dhe të provave do të respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionin ekzistues të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale.
85. Për më tepër, rregullat e procedurës dhe të provave do t'i nënshtrohen vlerësimit nga Dhoma e Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, si një garanci shtesë që do të respektohen të drejtat procedurale nga Kapitulli II i Kushtetutës.
86. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 6 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 7***

87. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 7, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai është i ndërlidhur me elementet e themeluara strukturore në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës dhe me garancitë e vendosura procedurale.
88. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 7 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 8***

89. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 8, të Kushtetutës, Gjykata vëren se çdo veprim që do të ndërmerret në raport me ndonjë person që do t'i nënshtrohet juridiksionit të dhomave të specializuara dhe të Zyrës së

Prokurorit të Specializuar duhet të jetë në harmoni me standardet e vendosura me të drejtën ndërkombëtare.

90. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 8 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

#### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 9***

91. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 9, të Kushtetutës, Gjykata vëren se përdorimi i gjuhës është një nga garancitë e të drejtës për gjykim të drejtë. Kësisoj, parashikohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe i gjuhës serbe, të cilat janë gjuhë zyrtare kushtetuese të Kosovës.
92. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 9 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

#### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 10***

93. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 10, të Kushtetutës, Gjykata vëren se emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe e prokurorëve do të përcaktohet me ligj.
94. Si të tilla, të gjitha ligjet i nënshtrohen parimeve të sanksionuara në Kushtetutë gjatë miratimit nga Kuvendi.
95. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 10 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

#### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 11***

96. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 11, të Kushtetutës, Gjykata vëren se është një garanci shtesë që do të mbrohen vlerat, parimet dhe standardet e Kushtetutës. Përjashtimi i paraparë i disa dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me Avokatin e Popullit të Kosovës është pasojë e kompetencës ekskluzive të Ombudspersonit të veçantë për t'u marrë me dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Kompetencat specifike të këtij ombudspersoni do të përcaktohen me ligj.
97. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 11 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.



### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 12***

98. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 12, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky amendament është i natyrës teknike, që do të parashihet në ligjin që do të miratohet nga Kuvendi.
99. Gjykata rithekson se ligji do t'i nënshtrohet parimeve të Kushtetutës gjatë miratimit nga Kuvendi.
100. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 12 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafët 13 dhe 14***

101. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafët 13 dhe 14, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky është në pajtueshmëri me parimin e sigurisë juridike.
102. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafët 13 dhe 14 të amendamentit të propozuar nuk pakësojnë të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

### ***Hyrja në fuqi e Amendamentit nr. 24***

103. Sa i përket hyrjes në fuqi të amendamentit nr. 24, Gjykata vëren se, teksti nën numrin romak II, që rregullon atë, është identik me nenin 144, paragrafi 4, të Kushtetutës, ku thuhet:

*“Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës”.*

104. Prandaj, Gjykata konfirmon se ky tekst i amendamentit nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
105. Si konkludim, për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konfirmon se Amendamenti i propozuar nr. 24 nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Rrjedhimisht, amendamenti i propozuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË të pranueshme kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, të dorëzuar më 9 mars 2015, me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- II. TË KONFIRMOJË që Amendamenti nr. 24 nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës si dhe në Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani